



KOMUNIKATË PËR SHTYP

18 maj 2018

KSC6-18

Pietro Spera emërohet Avokat i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës

Z. Pietro Spera me shtetësi italiane, u emëruar Avokat i Popullit i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Z. Spera ka thuar 30 vjet përvojë pune ligjore si gjykatës, veçanërisht për mbrojtjen e të drejtave në procedurat gjyqësore. Ndër të tjera, ai ka punuar si gjykatës ndërkombëtar në Dhomen për Krime Luftë dhe Krimin e Organizuar të Gjykatës Shtetërore të Bosnjë-Hercegovinës dhe gjithashtu në Afganistan, ku ka kryesuar disa projekte për fuqizimin e sundimit të ligjit në sistemin gjyqësor të Afganistanit.

Me rastin e emërimit, Avokati i Popullit Spera deklaroi:

“Emërimi si Avokat i Popullit i Dhomave të Specializuara është një nder dhe privilegj për mua dhe jam i gatshëm për sfidën e përmbushjes së mandatit që më është besuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.”

Avokati i Popullit luan një rol thelbësor në monitorimin, mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore mishëruar në Kushtetutën e Kosovës të të gjithë personave që kanë punë me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Nga ana tjetër, Avokati i Popullit nuk mund të ndërhyjë në procedura gjyqësore të Dhomave të Specializuara, përveçse në rast të vonesave të paarsyeshme. Gjithashtu, Avokati i Popullit mund t'i paraqesë rekomandime Kryetarit të Dhomave të Specializuara ose Prokurorit të Specializuar për çështje që janë pjesë e funksioneve të tyre.

Duke e përgëzuar Avokatin e Popullit Spera, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, gjykatësja Ekaterina Trendafilova, deklaroi:

“Sot është një ditë e rëndësishme për Dhomat e Specializuara. Emërimi i z. Spera si Avokat i Popullit shënon një moment tjetër kyç për institucionin tonë. Mandati dhe roli unik i Avokatit të Popullit e bëjnë atë garantues të të drejtave themelore të kujtqo që ka punë me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, duke mundësuar përmbushjen e standardeve më të larta të të drejtave të njeriut.”

Më shumë informacion mbi Avokatin e Popullit mund të gjeni në faqen në [Internet të Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar](#).

KONTAKT:

Njësia e Dhomave të Specializuara për Informim dhe Komunikim me Publikun:

mediaKSC@scp-ks.org, tel: +31(0)6 249 21 036

Më shumë informacion mbi Dhomat e Specializuara të Kosovës mund të gjeni në: www.scp-ks.org